



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Eventiv Sportiv të organizuar nga "Ekipet Sportive në Shkollë".

"Procedurë Prokurimi për Shërbimin e Printimit të Buletineve të Volejbollit, Basketbollit dhe Buletineve Shkencore" në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkollë".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

- 1. Rreth KOKSH**
- 2. Rreth shërbimit të kërkuar.....**
- 3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.....**
- 4. Metodologjia dhe plani i punës**
- 5. Kualifikimet e nevojshme**
- 6. Procesi i aplikimit.....**
- 7. Dorëzimi i ofertave**
- 8. Afati i Aplikimit.....**
- 9. Procesi i Vlerësimit.....**
- 10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak**



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur objektivat e projektit "Ekipet Sportive në Shkolla" dhe për të dokumentuar e promovuar aktivitetet e zhvilluara në kuadër të tij, parashikohet realizimi i shërbimit të printimit të buletineve të volejbollit, basketbollit dhe buletinit shkencor.

Buletinet do të shërbejnë si materiale informuese dhe promovuese, duke pasqyruar aktivitetet sportive, rezultatet, pjesëmarrjen e nxënësve, si dhe përmbajtje me karakter edukativ dhe shkencor në funksion të projektit.

Shërbimi përfshin printimin e:

- 200 (dyqind) kopjeve të buletinit të volejbollit;
- 200 (dyqind) kopjeve të buletinit të basketbollit;
- 100 (njëqind) kopjeve të buletinit shkencor;

Ftojme individët dhe kompanitë që ushtrojnë aktivitet në fushën e shtypshkronjës dhe printimit të materialeve të botuara, dhe që janë të interesuara për bashkëpunim, të angazhohen në realizimin e këtij shërbimi në kuadër të projektit **"Ekipet Sportive në Shkolla"**.

Nëpërmjet kësaj thirrjeje të hapur, KOKSH fton individët/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e procedurës.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmimi pa Tvsh	Vlera	Burimi i Financimit	Kohëzgjatja/ Periudha e përmbajtjes
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>l</i>	<i>2</i>	<i>3=lx2</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
1	Shërbim për printimin e buletineve të volejbollit, basketbollit dhe buletinit shkencor	Printimi i 200 kopjeve të buletinit të volejbollit, 200 kopjeve të buletinit të basketbollit dhe 100 kopjeve të buletinit shkencor, sipas specifikimeve teknike dhe kërkesave të AK	Cope	-200 buletine basketbolli -200 buletine volejbolli -100 buletine shkencor	lekë		Qeveria Shqiptare financim projekti "Ekipet Sportive ne Shkolla".	Sipas afateve të përcaktuara në kuadër të zbatimit të projektit "Ekipet Sportive në Shkolla".

4. Metodologjia dhe plani i punës

Për realizimin me cilësi të këtij shërbimi, do të përzgjidhet operatori ekonomik që paraqet ofertën më të favorshme ekonomikisht, në përputhje me kërkesat teknike dhe financiare të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Metodologjia e ndjekur do të përfshijë:

- Identifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik përmes një procesi transparent dhe konkurrues;
- Marrjen e materialeve për printim nga Autoriteti Kontraktor, sipas specifikimeve të përcaktuara;
- Printimin e 200 (dyqind) kopjeve të buletinit të volejbollit, 200 (dyqind) kopjeve të



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

buletinit të basketbollit dhe 100 (njëqind) kopjeve të buletinit shkencor, në përputhje me specifikimet teknike të miratuara;

- Kryerjen e kontrollit të cilësisë së materialeve të printuara për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat teknike dhe standardet e kërkuara;
- Dorëzimin e materialeve të printuara pranë Autoritetit Kontraktor, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- Monitorimin e realizimit të shërbimit dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Autoritetin Kontraktor deri në përfundimin e plotë të kontratës.

Kohëzgjatja e këtij shërbimi do të jetë në përputhje me afatet e zbatimit të projektit **"Ekipet Sportive në Shkollë"**, duke synuar përfundimin e printimit dhe dorëzimin e buletineve brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

5. Kualifikimet e nevojshme

- Regjistrimi ligjor: Subjekti duhet të jetë i regjistruar në QKB dhe të ketë në objekt të veprimtarisë shërbime në fushën e botimeve, shtypshkronjës ose të ngjashme;
- Të paraqesë ofertën në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor;
- Kapacitet për printimin dhe botimin e librit sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Për të qenë i përshtatshëm për këtë prokurim, ofertuesi duhet të plotësojë këto kritere kualifikuese:

- Eksperiencë e mëparshme në përgatitjen ose botimin e librave apo materialeve;
- Aftësi për të ofruar shërbimin sipas kërkesave, duke garantuar cilësinë e printimit dhe afatet kohore të dorëzimit;
- Përgatitja e një oferte të detajuar, që pasqyron çmimin.
- Kapacitet teknik dhe profesional për realizimin e shërbimit design, faqosjes dhe përgatitjes për shtyp të librit;
- Aftësi për bashkëpunim dhe koordinim me autoritetin kontraktor gjatë gjithë fazave të procesit (draft, miratim).

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte dhe person kontakti.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

6. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 06.05.2026 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Çmimi - Vlerësohet oferta më e favorshme ekonomike, bazuar në çmim	70%
Cilësia dhe kapaciteti – Vlerësohen cilësia e ofertës teknike, cilësia e printimit, si dhe aftësia e operatorit për realizimin dhe dorëzimin e buletineve brenda afateve.	30%

9. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.